



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



02/Nr. 5065 /2021
Datë: 06.08.2021

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 57 të Statutit të komunës së Hani të Elezit, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës së Hani të Elezit, merr këtë:

V E N D I M

- 1. APROVOHEN, Procedurat Standarde të Operimit (PSO) të të hyrave komunale**, si pjesë përbërëse e Doracakut “**Libri i Proceseve për menaxhimin e shpenzimeve publike**” me nr.02/9423/2020, i cili aktualisht përmban proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. **Këto procedura standarde të operimit do të shërbejnë si procedura të brendshme për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë, gjeodezia, lejet e ndërtimit, dokumentet e gjendjes civile, lejet për prona komunale.**
- 2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:**
 - PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë;
 - PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga gjeodezia;
 - PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga lejet e ndërtimit;
 - PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga dokumentet e gjendjes civile; dhe
 - PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga prona komunale.
- 3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.
- 4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i komunës.**

Me këtë Vendim njoftohen:

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës

